

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sika MonoTop®-634 HP

LLAÇ ÇIMENTOJE ME PERFORMANCË TË LARTË DHE PËR SHUMË PËRDORIME QË APLIKOHET ME DERDHJE PËR SHTRIM DYSHEMESH DHE PUNIME RIPARIMI TË BETONIT, MBUSHJE NË TRASHËSI TË MADHE DHE ANKORIME



PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sika MonoTop®-634 HP është llaç çimentoje me 1 përbërës dhe i përforcuar me fibra (teknologji SCC self-compacting concrete, beton i vetëkompaktueshëm) që aplikohet me derdhje dhe përdoret për shtrim dyshemesh dhe punime riparimi të betonit, mbushje dhe ankorime, i cili plotëson kërkesat e EN 1504-3 (kategoria R4), EN 1540-6 dhe EN 13813 (CT-C50-F7-AR6). Sika MonoTop®-634 HP është llaç çimentoje me rrjedhë të lirë dhe me tkurrje shumë të ulët.

PËRDORIMET

Sika MonoTop®-634 HP është llaç çimentoje me performancë të lartë, tkurrje të kompensuar dhe rrjedhë të lirë për trashësi shtrese midis 10mm dhe 100mm, i përshtatshëm për:

- Restaurim betoni me derdhje llaçi brenda betoformave (trarë, kolona, kuverta urash).
- Punime përforcimi elementësh prej betoni me veshje prej betoni të dredhur
- Rikonstrukcion i dysHEMEVE industriale prej çimentoje me rezistencë të lartë ndaj abrazionit.
- Aplikime ankorimi si bulona (ankorazhe, vida fiksuese, etj.).
- Mbushje me derdhje ose pompim të plasaritjeve, boshllëqeve dhe zgavrave në beton, mur, shkëmb, etj.
- Punime restaurimi (Parimi 3, metoda 3.2, EN 1504-9:2008). Riparim i betonit të copëtuar dhe të dëmtuar në ndërtesa, ura, vepra infrastrukture dhe superstrukture me derdhje betoni.
- Përforcim strukturor (Parimi 4, metoda 4.2, EN 1504-9:2008). Instalim shufrash brenda birave të shpuara tek betoni.
- Përforcim strukturor (Parimi 4, metoda 4.4, EN 1504-9:2008). Shtim i kapacitetit bartës i strukturës prej betoni duke shtuar llaç.
- Aplikime dyshemesh (EN 13813, CT-C50-F7-AR6). Rikonstrukcion i dysHEMEVE industriale prej çimentoje në mjedise të brendshme e të jashtme me

rezistencë të lartë ndaj abrazionit/ konsumimit.

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Përdorim i lehtë, pluhur gati për përzierje; thjesht shtoni ujë
- Konsistencë SCC e adaptueshme (teknologjia Sika® ViscoCrete®), veti të shkëlqyera rrjedhjeje, punueshmëri dhe qëndrueshmëri
- Rezistencë e lartë ndaj abrazionit / konsumimit, kategoria AR6 me metodën BCA
- Pa segregim ose rrjedhje
- Kompensim i jashtëzakonshëm i tkurrjes (në fazë plastike dhe të ngurtësuar)
- Mund të derdhet dhe/ose pompohet
- Për trashësi aplikimi midis 10mm dhe 100mm (pa agregate)
- Në përputhje me standardin EN 1504-3 si llaç riparues (Kategoria R4)
- Në përputhje me standardin EN 1504-6 si produkt ankorimi
- Në përputhje me standardin EN 13813 si llaç për aplikime dysHEMEJE (CT-C50-F7-AR6)
- Klasifikimi i zjarrit A1

MIRATIME / STANDARDE

- Markë CE dhe Deklaratë Performance si llaç për riparime PCC, Kategoria R4, për riparimin strukturor të strukturave prej betoni në ndërtesa dhe vepra të inxhinierisë së ndërtimit sipas EN 1504-3:2005, bazuar në certifikatën e kontrollit të prodhimit në fabrikë të lëshuar nga organi i certifikimit të kontrollit të njoftuar të prodhimit në fabrikë dhe lloji i testimit.
- Markë CE dhe Deklaratë Performance si produkt ankorimi për përforcimin e betonit me instalim çeliku përforcues (shufra) në ndërtesa dhe vepra të inxhinierisë së ndërtimit sipas EN 1504-6:2006, bazuar në certifikatën e kontrollit të prodhimit në fabrikë të lëshuar nga organi i certifikimit të kontrollit të njoftuar të prodhimit në fabrikë dhe lloji i testimit.
- Markë CE dhe Deklaratë Performance si llaç

çimentoje për dyshemetë, CT-C50-F7-AR6 sipas EN 13813:2002, bazuar në llojin e testimit dhe kontrollin e prodhimit në fabrikë.

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Çimento Portland, agregate të përzgjedhura, fibra sintetike dhe aditivë të posaçëm		
Ambalazhi	Thes 25 kg		
Paraqitja / Ngjyra	Pluhur gri me fibra		
Jetëgjatësia	12 muaj nga data e prodhimit		
Kushtet e magazinimit	Të ruhet në ambalazhin origjinal, të pahapur dhe të padëmtuar, në kushte të thata dhe temperatura midis +5°C dhe +35°C.		
Dendësia	Dendësia e llaçit të freskët: ~ 2.2 kg/lt		(EN 1015-6)
Përmasa maksimale e kokrrizës	~ 3.5mm		
Përmbajtja në jone të tretshme kloruri	≤ 0.05%		(EN 1015-17)

TË DHËNA TEKNIKE

Rezistenca ndaj ngjeshjes	1 ditë	7 ditë	28 ditë	Kërkesat R4-28 ditë	(EN 12190)
	≥ 20 MPa	≥ 40 MPa	≥ 52 MPa	≥ 45MPa	
Moduli i elasticitetit në ngjeshje	Rezultatet		Kërkesat (R4)		(EN 13412)
	~ 26GPa		≥ 20GPa		
Rezistenca ndaj tërheqjes në përkulje	1 ditë	7 ditë	28 ditë		(EN 196-1)
	≥ 3 MPa	≥ 5 MPa	≥ 8 MPa		
Rezistenca e ndërkapjes në tërheqje	Rezultatet		Kërkesat		(EN 1542)
	≥ 2.0 MPa		≥ 2.0 MPa		
Tkurrja / bymimi i kontrolluar	> 2.0 Mpa				(EN 12617-4)
Rezistenca ndaj abrazionit	AR6				(EN 13892-4)
Kompatibiliteti termik	≥ 2.0 MPa (ndërkapje pas 50 ciklesh)				(EN 13687-1)
Reagimi ndaj zjarrit	Euroclass A1				(EN 13501-1)
Absorbueshmëria kapilare	≤ 0.5 kg m ⁻² h ^{-0.5}				(EN 13057)
Hyrja e joneve të klorureve	Rezultatet		Kërkesat		(EN 13396)
	< 0.01 %*		Vlera e deklaruar		
* Vlera pas 6 muajsh në thellësi 10 mm					
Rezistenca ndaj karbonimit	dk ≤ beton kontrolli (MC (0.45))				(EN 13295)

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Raporti i përzjerjes	3.5 - 4.0 lt ujë për thes 25kg		
Konsumimi	~ 2.0 kg pluhur për 1 mm trashësi për m ² , në varësi të ashpërsisë së nënshtrësës dhe dendësisë së llaçit të freskët.		
Rendimenti	25 kg pluhur prodhon ~12.5 litra llaç		
Trashësia e shtresës	10 mm min. / 100 mm max.		
Konsistenca	~ 230 mm		Metodë e brendshme Sika EN12350-2 me konin Abrahams
	70-75 cm		

Fleta e të dhënave të produktit
Sika MonoTop®-634 HP
Prill 2019, Botimi 01.01
020302040030000159

Temperatura e mjedisit	+5°C min. / +35°C max.
Temperatura e nënshtresës	+5°C min. / +35°C max.
Koha e punueshmërisë	~ 30 minuta në +20°C

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

Betoni:

Nënshtresa duhet të ketë strukturë të qëndrueshme, të jetë plotësisht e pastër dhe pa pluhur, pislleqe dhe materiale të lira, kontaminues të sipërfaqes si vaj apo graso, kore çimentoje të cilat reduktojnë ndërkapjen, parandalojnë përthithjen apo ndikojnë tek rrjedhja e llaçit. Betoni i shpetëzuar, i dobët dhe i dëmtuar dhe kudo që nevojitet edhe betoni i shëndetshëm -por jo deri në dëmtim të intergritetit strukturor- duhet të hiqet me teknika të përshtatshme të përgatitjes mekanike, si pastrim me ujë në presion të lartë ose fryrje me rrymë rëre. Nuk preferohen metoda pastrimi me vibrim. Ashpëroni sipërfaqen e betonit për të ekspozuar agregatet deri në thellësi 2 mm, në përputhje me EN 1766 ose CSP 5 nga Udhëzimet ICRI. Skajet e zonës së ndikuar nga ndërhyrja duhet të priten në mënyrë përpjendikulare (90°) deri në thellësi min. 5mm. Rezistenca e betonit ndaj tërheqjes duhet të jetë > 1.5 MPa. Ndiqni udhëzimet e dhëna nga supervizori ose një inxhinier i kualifikuar.

Çeliku:

Sipërfaqja e armaturës prej çeliku nuk duhet të ketë ndryshk, smërc, llaç, mbetje betoni, pluhur dhe materiale të tjera të lira të cilat mund të reduktojnë ngjitjen ose mund të shkaktojnë korrodin. Në rast ndryshku, pastroni në mënyrë të njëtrajtshme të gjithë sipërfaqen e shufrave prej çeliku (aty ku aplikohet) me teknika pastrimi me rrymë abrazive ose fryrje uji me presion të lartë deri në Sa 2 në përputhje me ISO 8501. Mbroni shufrat e pastruara nga kontaminimi i mëtejshëm, përpara aplikimit të llaçit.

Betoforma:

Çdo betoformë duhet të ketë kapacitetin për të përballuar ngarkesën dhe forcat që i ushtrohen. Betoforma duhet të jetë e pastër dhe e vendosur në pozicion pas përgatitjes së nënshtresës dhe armaturës. Disarmantët nga seria Sika® Separol®, duhet të aplikohen përpara vendosjes së shufrave në pozicion për të shmangur kontaktin me nënshtresën e përgatitur. Betoforma duhet të jetë projektuar saktë për të lejuar rrjedhjen e ajrit dhe ujit, për të përballuar teknikën e derdhjes, për të ofruar mbushje të plotë, për të siguruar rrjedhjen e lirë, për të parandaluar rrjedhjen e produktit, etj. Ju lutemi këshillohuni me departamentin teknik Sika për më tepër udhëzime specifike.

Duhet të referoheni gjithashtu tek EN1504-10 për kërkesa specifike.

PËRZIERJA

Sika MonoTop®-634 HP mund të përzihet me mikser manual në shpejtësi të ulët (~500 r.p.m.) me aks vertikal për 1 deri në 2 thasë duke u kujdesur për të mos bllokuar ajër brenda miksit, ose duke përdorur një mikser me kovë me veprim të detyruar për 2 deri në 3 thasë -ose më tepër- menjëherë, në varësi të llojit dhe madhësisë së mikserit. Hidhni ujin në raportin e saktë të dëshiruar brenda një ene të përshtatshme për përzierje. Ndërsa jeni duke përzierë ngadalë, shtoni gradualisht pluhurin tek uji dhe përzieni plotësisht për të paktën 3 min. duke hedhur ujë shtesë (nëse nevojitet) gjatë kohës së përzierjes deri në sasinë maksimale të specifikuar derisa të arrihet konsistenca e kërkuar homogjene pa kokrriza. Për mikse më të mëdha, koha e përzierjes mund të zgjatet (deri në 5 minuta ose sa nevojitet) derisa llaçi të jetë përzierë në mënyrë homogjene pa kokrriza apo mbetje pluhuri të thatë. Përzieni thasë të plotë për rezultate më të mira. 25 kg pluhur Sika MonoTop®-634 HP përzihet me 3.5 - 4.0 L ujë në varësi të konsistencës së kërkuar.

APLIKIMI

Sika MonoTop®-634 HP mund të aplikohet manualisht me teknika tradicionale derdhjeje brenda kaviteve ose betoformave. Nëse nevojitet, mund të pompohet mekanikisht me pajisje standarde (p.sh. Turbosol, Putzmeister).

Lagje paraprake:

Sipërfaqet prej betoni duhet të ngopen me ujë të pastër min. 2 orë përpara aplikimit, duke u siguruar se të gjitha poret dhe gropat janë mjaftueshëm të lagura. Sipërfaqja nuk lejohet që të thahet përpara aplikimit të llaçit. Pak përpara aplikimit, hiqni ujin e tepruar dhe sigurohuni se nuk ka pellg uji mbi sipërfaqe. Sipërfaqja duhet të arrijë një paraqitje të errët mat pa shkëlqim dhe poret dhe gropat e sipërfaqes nuk duhet të përmbajnë ujë (tharje e ngopur e sipërfaqes, saturated surface dry - SSD). Përdorni ajër me presion (pa vaj) për të fryrë ujin e tepruar në zonat e vështira për t'u arritur.

Derdhja / mbushja:

Produkti duhet të hidhet direkt mbi nënshtresën e lagur mat ose brenda betoformës të përgatitur për derdhjen. Duke përdorur më shumë se 1 mikser dhe me organizimin e duhur, ju mund të derdhni materialin e freskët duke reduktuar fugat e ndërtimit. Pas përzierjes së Sika MonoTop®-634 HP, lëreni llaçin të qëndrojnë për ~1-2 minuta; përzieni sërish me mallë dhe pastaj hidhni brenda betoformave të përgatitura, të izoluar, të papërkulshme - të qëndrueshme. Për të përfituar sa më shumë nga vetitë e zgjerimit të llaçit aplikoni llaçin sa më shpejtë të jetë e mundur (max. brenda 15 minutave). Duhet të merren në konsideratë koha e punueshmërisë dhe kushtet klimaterike gjatë planifikimit të kohëzgjatjes së punimeve.

Prajmer / mbrojtje kundër korrodimit të armaturës:

Në përgjithësi, mbi një nënshtresë të përgatitur mirë

dhe të ashpërsuar, nuk nevojitet prajmer. Aty ku kërkohet prajmer dhe/ose veshje përforcuese (p.sh. Sikadur®-32 EF, Sika MonoTop®-910 ose SikaTop® Armatec®-110 EpoCem®) referohuni tek skeda teknike përkatëse për më tepër informacione të detajuara. Në çdo rast, prajmeri / mbrojtja kundër korrodimit të armaturës duhet të aplikohet mbi një nënshtresë paraprakisht të lagur dhe aplikimi vijues i Sika MonoTop®-634 HP duhet bërë i lagësht mbi të lagësht. Duhet të merret parasysh nëse koha e punueshmërisë së prajmerit dhe/ose mbrojtjes kundër korrodimit të armaturës plotëson kërkesat e aplikimit.

METODA E MATURIMIT

Mbroni Ilaçin e freskët të aplikuar nga dehidratimi i hershëm dhe/ose tharja e parakohshme me metodat e përshtatshme të trajtimit (të paktën për 24 orë), p.sh. me përbërës trajtimi si Sika® Antisol® ose Sikafloor® Proseal sapo të ketë avulluar uji i sipërfaqes. Përdorni mbulesa të përshtatshme trajtimi si jutë dhe ujë, fleta plastike apo membrana të tjera të përshtatshme.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Heqja e mbetjeve të freskëta nga veglat dhe pajisja e aplikimit mund të bëhet me ujë menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar/ tharë mund të hiqet vetëm mekanikisht.

DOKUMENTA SHITESË

Për punime riparimi të betonit referohuni tek Sika Method Statement për "Restaurimin e strukturave prej betoni me derdhje duke përdorur Ilaçet gati për përdorim Sika®" (Ref. 8503202) për më tepër informacione rreth aplikimit të sistemit riparues, përgatitjes së nënshtresës dhe/ose referohuni tek rekomandimet e dhëna tek EN 1504-10.

KUFIZIME

- Në rastet e betonimit të dyshemesë ku mund të tejkalohej trashësia prej 100mm, ju lutem konsultohuni me departamentin teknik.
- Përzierja duhet të bëhet gjithmonë me mjete mekanike; përzierja manuale nuk lejon arritjen e punueshmërinë optimale.
- Mos shtoni ujë mbi dozën e rekomanduar.
- Mos shtoni çimento ose substanca të tjera që mund të ndikojnë tek vetitë e Ilaçit.
- Mos shtoni ujë ose Ilaç të freskët në një përzierje që ka filluar të mpikset.
- Shmangni aplikimin në rrezatim të drejtpërdrejtë diellor dhe/ ose erë të fortë.
- Aplikoni vetëm mbi nënshtresa të qëndrueshme dhe të përgatitura në mënyrën e duhur.
- Në rastet e betonimit të dyshemesë, sidomos në mjedise të jashtme, shmangni tharjen shumë të shpejtë të produktit gjatë ditëve të para të trajtimit.
- Mos derdhni dysheme në kushte të keqija moti, të cilat mund të ndikojnë negativisht procesin e mpiksjes dhe ngurtësimit të produktit.
- Mbroni produktin e aplikuar nga dielli dhe era për të paktën 24 orë pas aplikimit.
- Kontrolloni gjithmonë materialin pas pompimit.

- Sigurohuni se betoforma është mjaftueshëm e fortë për të mbajtur Ilaçin e freskët, dhe e izoluar për të parandaluar rrjedhjen.
- Trajtoni sipërfaqet e ekspozuara menjëherë me fletë ose membranë mbrojtëse. Mbroni Ilaçin e freskët nga dielli i drejtpërdrejtë, era dhe ngrica.
- Finironi sipërfaqen e ekspozuar sipas dëshirës, sapo Ilaçi të fillojë të forcohet. Mos shtoni më ujë mbi sipërfaqe.
- Shmangni rënien e lirë të materialit për të parandaluar segregimin e aggregateve.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositetë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park
Ndërtesa nr. 7, kati 4
Tiranë - Shqipëri
Tel.: +355 4 454 0070
alb.sika.com
Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit
Sika MonoTop®-634 HP
Prill 2019, Botimi 01.01
020302040030000159

SikaMonoTop-634HP-sq-AL-(04-2019)-1-1.pdf